

MAGJISTRATURA NE MESIMDHENIEN E GJUHES ANGLEZE

I. PERSHKRIMI GJENERAL

Qëllimi i këtij programi është që studentët t'i përgatis me dituritë themelore nga teoria gjuhësore dhe metodologjike dhe t'i njoftojë me shkathtësitë që janë të nevojshme për zbatimin e teorisë në mësimin praktik. Zgjidhja e planit mësimor dhe lëndëve individuale e reflektojnë drejt perse drejti natyrën e mësimit dhe përvetësimit të një gjuhe të dytë në përputhje me nevojat dhe realitetin rajonal e lokal të mësimdhënies. Meqë programi është dizajnuar për folës joamtar të gjuhës angleze, përfshihet një komponent për studim të gjuhës angleze të avancuar me një theks të posaçëm mbi leximin dhe shkrimin akademik. Ekziston edhe komponenta për hulumtime (sasiore dhe cilësore) akademike, si dhe hulumtime bashkëkohore.

Semester I

- Metodologjia e mësimdhënies së gjuhës së huaj
- Gramatika e gjuhës angleze
- Metodologjia e hulumtimit
- Shkrimi pedagogjik
- Mesimi I vokabularit

Semestri II

- Të mësuarit dhe përvetësimi i gjuhës së dytë
- Çështjet në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze
- Gjuha Angleze për qellime specifike
- Mësimi i gjuhës me ndihmën e kompjuterit
- Seminar për shkruarjen e tezës së Magjistraturës

Semestri III

- Teza dhe puna praktike (30 kredi)

IV. Kushtet e regjistrimit

Përvec kushteve të përgjithshme për regjistrim të programeve në ciklin e dytë të studimeve në UEJL, për këtë program kandidatët duhet t'i plotësonë edhe këto kushte:

- 1) Diplomë e ciklit të parë (BA) të studimit të gjuhës angleze, gjuhëve të huaj, komunikimit, pedagogjisë, filologjisë dhe fushave përkatëse.
- 2) Njohja e shkëlqyeshme të gjuhës angleze (TOEFL 580 pikë/237 pikë kompjuterike, IELTS 6.5)
- 3) Shkathtësitë themelore për njohjen e kompjuterëve; njohja e softverit të popullarizuar (word, excel, power point)

4) Mesatarja më e lartë se 8.5

5) Mendim pozitiv nga komisioni për pranim (studentëve me diplomë nga disiplina tjera mund t'u ofrohen lëndë plotësuese nga provimet e studimit të rregullt.

Për ata që nuk i plotësojnë kushtet minimale për pranimin e programit për ligjërimin e anglishtes, do të ketë program veror (pagesë shtesë) që t'u ndihmohet të fitojnë kualifikime minimale.

Magjistratura në mësimdhënien e gjuhës Angleze

SEMESTRI 1

1. Metodologjia e mësimdhënies së gjuhës së huaj dhe ushtrime 6 kredi

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: studimi i metodave kryesore të mësimdhënies duke filluar nga Përkthimi Gramatikor përmes Qasjeve Komunikative me theks të posaçëm në aplikimin praktik të metodologjisë së Mësimdhënies së Gjuhës Angleze.

Ligjërues: J.P.Colgan

Asistent: H. Dixon, V.Kareva

2. Gramatika 6 kredi

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: qasje praktike drejt metodave dhe strategjive të reja në ligjërimin e gramatikës, duke filluar nga ushtrimet gramatikore deri te teknikat e ngritjes së vetëdijes.

Ligjërues: I.Mehmeti

Asistent: I.Mehmeti

3. Metodologjia e humlumlumit 6 kredi

Përshkrimi i shkurtër : studimi i punës dhe metodave humlumluese përfshirë ketu grupimin e informative, formimin e hipotezës, testimin dhe gjurmimin eksperimental. Gjatë kursit, studentët do të mësojnë ta zhvillojnë aftësinë e gjurmimit, i nevojshëm për krijimin implementimin dhe kompletimin e suksesshëm të projektit gjurmues.

Ligjërues: F. Muhiç

Asistent: F. Muhiç

4. Shkrimi pedagogjik 6 kredi

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kjo lëndë do të shqyrtoj metodat më të reja të mësimin të shkrimit në mësimdhënien e gjuhës së huaj. Vëmendje e posaçme do të kushtohet konceptit prodhim përkunder qasjeve të orientuara drejt prodhimit.

Ligjërues: F.Bigagli

Asistent: F.Bigagli, Mr T. Hays, M.Ed (Shkrimtar visitorë)

5. Mesimi i vokabularit

6 kredi

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: ky kurs do ta studijojë rilindjen e kësaj fushe interesante përmes studimit të së kaluarës historike dhe burimet multidiciplinare nga e cila ajo vet rrjedhon.

Gjithashtu do të studijohen një varg i strategjive efikase dhe praktike për t'u ndihmuar studentëve përvetësimin e fjalorit më të shpesht në komunikim, studimit akademik dhe fushës profesionale.

Ligjërues: J.P.Colgan

Asistent: Mr. B. Feldman, M.Ed

SEMESTRI II

1. Të mësuarit dhe përvetësimi i gjuhës së dytë **6 kredi**

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Studim i aspektit psikolingusik të mësimdhënies së gjuhës së huaj dhe të dytë në klasë dhe jasht saj.

Ligjërues:

Asistent

2. Gjuha Angleze për qëllime specifike

6 credits

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Studentët do të zhvillojnë vetëdije dhe kuptim kritik të principeve dhe praktikimin e anglishtes për qëllime specifike. Gjithashtu do të zhvillohen edhe njohuritë dhe aftësitë për negociim dhe arritjen e disajnit dhe implmentimit të kurseve efektive në varg kontekstesh.

Ligjërues:

Asistent:

3 Mësimi i gjuhës me ndihmën e kompjuterit

6 kredi

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kjo lëndë synon t'u ofroj studentëve një ide të gjërë dhe të përgjithshme për mësimin e Gjuhës Angleze me ndihmën e kompjuterit. Studentët do të përfshihen në ambientet ku zhvillohet procesi i mësimin të teorisë së gjuhës. Gjithashtu studentët do të kenë mundësi të diskutojnë dhe zbatojnë kompjuterët në klasë si dhe të krijojnë projekte dhe të njëjtët ti përdorin në testimin e diturisë së fituar përmes leximit, diskutimit dhe përvosjes.

Ligjërues:

Asistent:

4.Çështje në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze

6 kredi

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kjo lëndë nuk është një kurs i vetëm por një varg ligjëratash dhe seminaresh mbi tema dhe orientime nga lëmia në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze. Lëndët: Të Menduarit Kritik në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze, Intelejencia të Shumfishta, Përdorimi i Letërsisë në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze, Puna me femijë të vegjël, Mësimi bazuar në detyra konkrete, Përmisimi i Gabimeve, Dallimi i Zhanreve, Dallimet individuale, Vlerësimi, etj. do të ligjërohen nga profesorë mysafir të dalluar.

Ligjërues:

Asistent:

5. Seminar për shkruarjen e tezës së Magjistraturës

6 kredi

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kurs praktik për të shkruarit e tezës së Magjistraturës. Kjo do të përfshijë, përveç tjerash, si bëhet gjurmimi, si selektohet dhe përdoret stili dhe format të përshtatshme, dhe si ti largohemi plagjiaturës.

Ligjërues:

Asistent (ët)

SEMESTRI 3

Teza 30 kredi: Teza e Magjistraturës.

Detalet në lidhje me këtë do të përpunohen dhe definihen në koordinim me Univeristet egzistuese dhe normat e këshillit admisnitrativ.

